



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK KUÇOVË

Nr. 1006 Prot.

Kuçovë, më 04.03. 2026

V E N D I M

Nr. 18, datë 25/02 2026

“Për

**Miratimin e Dhënies së Ndhmës Financiare për familjet e përmytura në datat 10 dhe 11 Janar 2026, për Përballimin e Dëmeve të Shkaktuara nga Fatkeqësi Natyrore”.**

Këshilli Bashkiak, pasi u njohë me materialin e paraqitur nga Komisioni i Emergjencave Civile, Mbështetur në ligjin nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, dhe në zbatim të V.K.M –së nr 329 dt.16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, grupi i punës i ngritur me Urdhër të Brendshëm Nr.5 datë 12.01.2026 nga kryetari i Bashkisë ka evidentuar rastet si pasojë e fatkeqësisë natyrore nga përmytja nëpër banesa të datave 10 dhe 11 janar 2026, referuar shkresës të ardhur nga Këshilli Qarkut Berat me Nr. 93/1 datë 30.01.2026 protokolluar në institucionin tonë me Nr. 465 Prot. datë 02.02.2026, janë dërguar vlerësimi i dëmeve për familjet e prekura.

V E N D O S I:

1. Miratimin e fondit të emergjencës sipas preventivit të hartuar nga Këshilli i Qarkut Berat për familjet e prekura, ku do të dëmshpërblehen me 50% të shumës së preventivit, referuar tabelës si më poshtë:

Nr	Emër	Mbiemër	Nj/A dhe fshati	Vlera sipas preventivit në lekë	50% shumës në lekë që përfitojnë sipas ligjit
1	Tomor	Marra	Kozare / Salcë	549,200	274,600
2	Arben	Marra	Kozare / Salcë	201,000	100,500
3	Gezim	Merko	Perondi/Rr.Tapi	476,590	238,295
4	Riza	Marra	Kozare / Salcë	495,200	247,600
5	Besnik	Marra	Kozare / Salcë	578,500	287,750

*Ajuni*

6	Xhevit	Marra	Kozare / Salcë	698,352	349,176
7	Mehmet	Elezi	Kozare / Ferras	540,998	270,499
8	Rrapi	Mile	Kozare / Salcë	119,000	59,500
9	Klement	Marra	Kozare / Ferras	170,000	85,000
10	Hysen	Marra	Kozare / Ferras	174,000	87,000
11	Zabit	Marra	Kozare / Salcë	403,376	201,688

2. Ngarkohet Sektori i Emergjencave Civile dhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit për të ndjekur zbatimin e këtij vendimi.

3. Ky vendim hyn ne fuqi 10 ditë pas shpalljes

Ky vendim u miratua me   3   vota Pro,    vota kundër dhe    vota abstenim.

**KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK**  
**ALEKSANDËR ZIU**

